



## **Raport Përmbledhës**

### **Takimi i Grupit të Punës për Tërmetet dhe Mjedisin #7**

4 Tetor 2017 – Hotel Fieri

**Nga lehtësues të CAO-s**  
Rasim Gjoka, Adi Gavriila, Merita Bala

---

Ky raport përmbledh diskutimet dhe çështjet e rëna dakord në takimin e Grupit të Punës për Tërmetet dhe Mjedisin (nr.7), ku morën pjesë anëtarët e përhershëm të grupit të punës (anëtarë të komunitetit nga Patos-Marinza dhe përfaqësues nga kompania Bankers Petroleum Albania Ltd. (BPAL). Në këtë takim mori pjesë dhe një përfaqësuese nga zyra e CAO-s në Washington D.C, Anne-Claire Olivera, Analiste Kërkimesh, dhe tri ndërmjetëse vëzhguese.

\*\*\*

Takimi u parapri nga takime bilaterale me palët, të organizuara më 3 nëntor (me anëtarët e komunitetit) dhe 4 tetor (me anëtarët e kompanisë). Takimet bilaterale u fokusuan në eksplorimin e opsioneve për të kuptuar më mirë shkaqet e lëkundjeve të tokës dhe për të diskutuar për mënyrat për interpretimin e të dhënave të studimit të Universitetit “Aristoteli” i Selanikut (UAS). Në takimet bilaterale, CAO prezantoi për palët metodologjinë e procesit të përbashkët të gjetjes së fakteve, i cili është përdorur nga CAO në disa raste.

Përveç takimeve me palët, grupi i CAO-s pati paraprakisht takime me institucione shtetërore (me përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKBN-së, si dhe me Albpetrolin), për të diskutuar në lidhje me opinionin e tyre lidhur me raportin e UAS-it dhe me hapat e ndërmarra nga qeveria në lidhje me këtë çështje.

\*\*\*

Raporti është përgatitur nga lehtësuesit e CAO-s. Pjesëmarrësve të takimit iu kërkua rishikonin këtë raport përmbledhës dhe të bënin sugjerime, korigjime ose reflektive.

#### **AGENDA**

1. Eksplorimi i opsioneve dhe diskutimi për hapat e mëtejshëm drejt zgjidhjes së çështjes që lidhet me aktivitetin sizmik
2. Diskutime dhe dakortësi për listën e çështjeve të Tërmeteve dhe Mjedisit
3. Diskutim për një vizitë të mundshme në terren për të parë investimet për mjedisin
4. Hapat e mëtejshëm

## **1. Eksplorimi i opsioneve dhe diskutimi për hapat e mëtejshëm drejt zgjidhjes së çështjes që lidhet me aktivitetin sizmik**

Qëllimi kryesor i takimit të Grupit të Tërmeteve dhe Mjedisit ishte eksplorimi i opsioneve, diskutimi dhe arritja e dakortësisë për hapat e mëtejshëm që mund të ndërmerren grupi i punës në lidhje me zgjidhjen e çështjes që lidhet me aktivitetin sizmik, duke pasur parasysh që kjo është çështja kryesore e ngritur në ankesën drejtuar CAO-s.

Grupi i CAO-s ftoi pjesëmarrësit të jepnin opinionet e tyre në lidhje me opsionet që mund të ndërmerren, meqë, si komuniteti dhe kompania, janë të interesuar për të pasur më shumë informacion për shkaqet e tërmeteve. Anëtarët e komunitetit ishin gjithashtu të interesuar për procesin e kompensimit të ndërmerren nga qeveria.

Diskusioni i opsioneve u ndërthur me ndarjen e informacionit për situatën aktuale në lidhje me lëvizjet e tokës, shkaqet e mundshme të pretenduara nga komuniteti, gjetjet e studimit nga Universiteti "Aristoteli" i Selanikut, procesin e kompensimit, mungesën e vullnetit të qeverisë për ta zgjidhur çështjen, kontratën e kompanisë me qeverinë, mundësinë për zhvendosjen e banorëve, rolin e kompanisë dhe rolin e qeverisë për investimet, etj.

Anëtarët e komunitetit theksuan se që prej muajit dhjetor 2016 nuk kishte pasur lëvizje të tokës, të paktën lëvizje që mund të ndjehen nga njerëzit, përveç një lëvizjeje në shtator, duke shtuar se ata do të ishin të kënaqur me situatën për sa kohë kompania do të vazhdojë të punojë siç kishin bërë gjatë 10 muajve të fundit. Kompania theksoi se sizmometrat e instaluar në zonën e fushës naftëmbajtëse vazhdojnë të tregojnë se çdo muaj ka tërmete, por që në përgjithësi nuk ndjehen në sipërfaqe.

Bazuar në të dhënat sizmike të regjistruara, opinioni i kompanisë ishte se ata nuk besojnë se aktiviteti sizmik ishte ndaluar apo se pezullimi operacioneve të asgjësimit në Zharrëz kishte pasur ndonjë efekt domethënës në shfaqjen e aktivitetit sizmik në zonë, megjithatë kompania mbetet shumë e interesuar për të ditur shkaqet. Ata përmendën se kompania nuk ka plane imediate për të filluar operacionet në tri pusët për largimin e ujit në Zharrëz apo për të bërë ndryshime domethënëse në operacionet aktuale, të paktën jo pa pasur një tjetër vendim nga qeveria shqiptare.

Opsionet e ndryshme të sugjeruara në lidhje me procesin për të kuptuar më mirë shkaqet e lëkundjeve përfshijnë:

- Të ftohen ekspertë, me konsensusin e palëve, nga institucionet përkatëse për të ndarë informacion dhe për të interpretuar të dhënat e marra nga sizmometrat që prej lidhjes së tyre me rrjetin sizmik kombëtar;
- Të ftohen ekspertë për të komentuar mbi gjetjet e studimit nga UAS;
- Të dy palët të komunikojnë me grupin e punës ndërministror dhe të kërkojnë të jenë pjesë e grupit, duke pasur në këtë mënyrë një ndërmarrje tri-palëshe: qeveri-kompani-komunitet;
- Të bëhet një studim tjetër në emër të Grupit të Dialogut, dhe të financohet nga burime të pavarura;
- Të pritët për raportin e qeverisë dhe të krahasohen gjetjet me raportin nga UAS;
- Të dyja palët të punojnë bashkërisht për t'iu adresuar qeverisë për të marrë informacion nga grupi ndërministror mbi statusin e procesit qeveritar.

Në vijim të diskutimit të opsioneve, palët ranë dakord për të ndjekur veprimet si më poshtë:

- Grupi i punës do t'u dërgojë një letër të përbashkët institucioneve publike përkatëse, ku të kërkohet informacion mbi statusin e procesit të ndërmarrë nga qeveria për identifikimin e shkaqeve të tërmeteve.
- Letra do të publikohet në faqen e internetit të CAO-s.
- Procesi i Dialogut i lehtësuar nga CAO për veprime të përbashkëta për të identifikuar shkaqet e tërmeteve do të pezullohet deri në marrjen e përgjigjes nga institucionet shtetërore në lidhje me procesin paralel dhe për hapat e ndërmarra nga qeveria për të qartësuar situatën.
- Grupi i punës për Tërmetet & Mjedisin do të vazhdojë diskutimin e çështjeve të tjera të mjedisit në listën përkatëse, ndërkohë që çështja e tërmeteve është lënë pezull.

## **2. Diskutime dhe dakortësi për listën e çështjeve të Tërmeteve dhe Mjedisit**

Diskutimi u fokusua në aktivitetin sizmik dhe çështjet e tjera që janë në listën e çështjeve të tërmeteve dhe mjedisit nuk u diskutuan në detaje. Lista do të diskutohet në takimin e radhës së Grupit të Tërmeteve dhe Mjedisit.

## **3. Diskutim për një vizitë të mundshme në terren për të parë investimet për mjedisin**

Siç u ra dakord në takimin e fundit të përbashkët në korrik 2017, komuniteti dhe kompania ranë dakord për të bërë një vizitë në terren për të parë investimet e fundit për përmirësimin e mjedisit. Vizita do të organizohet në fund të muajit tetor ose fillim të muajit nëntor 2017.

## **4. Hapat e mëtejshëm**

- Grupi i punës do t'u dërgojë një letër të përbashkët institucioneve publike, ku të kërkohet informacion në lidhje me statusin e procesit të ndërmarrë nga qeveria për identifikimin e shkaqeve të tërmeteve:
  - Letra do të hartohet nga një grup i përbashkët komunitet-kompani, i përbërë nga Adriatik Golemi (BPAL) Nevila Naka (anëtarë nga komuniteti), Qani Rredhi (Drejtuues i Organizatës së Zharrëzës për Mbrojtjen e Mjedisit). Z. Adriatik do të koordinojë procesin e hartimit të letrës. Drafti final do të përfundohet brenda datës 8 tetor.
  - Letra do të qarkullohet nga CAO te anëtarët e tjerë të grupit të punës për komente/sugjerime dhe do të firmoset nga pjesëmarrësit në takim. Letra do të dërgohet brenda muajit tetor.
  - Letra do t'i dërgohet Zyrës së Kryeministrit, dhe për dijeni Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë, IGJEUM, AKBN dhe Albpetrol-it.
  - CAO do të ndjekë çështjen e kthimit të përgjigjes nga institucionet për letrën.
  - Në rast se nuk do të merret përgjigje për dy javë, do t'i dërgohet një ankesë Komisionerit për Informacion dhe Mbrojtjen e të Dhënave.
  - Letra do të publikohet në faqen e internetit të CAO-s.
- Procesi i Dialogut i lehtësuar nga CAO për veprime të përbashkëta për të identifikuar shkaqet e tërmeteve do të pezullohet deri në marrjen e përgjigjes nga institucionet

shtetërore në lidhje me procesin paralel dhe hapat e ndërmarra nga qeveria për të qartësuar situatën.

- Ndërkohë që diskutimi i çështjes së tërmeteve do të jetë i pezulluar, Grupi i Tërmeteve dhe Mjedisit do të do të diskutojë çështjet e tjera të listës së grupit përkatës.
- Në fund të muajit tetor ose fillim të muajit tetor do të organizohet një vizitë në terren. CAO do të koordinojë me kompaninë për kohën dhe përgatitjet e tjera.
- Takimi i radhës i Grupit të Punës të Tërmeteve dhe Mjedisit do të mbahet në muajin nëntor.